

KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE
NJOFTIMI I PROCEDURËS KONKURRUESE

Zhvilluesi i Projektit të Investimit:	Korporata e Investimeve Shqiptare
Emri i Projektit të Investimit:	“Zhvillimi dhe menaxhimi i godinave shtetërore”
Nënprojekti:	“Ndërtimi dhe menaxhimi i Kompleksit Governativ”
Titulli i kontratës:	“Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i VOID Tower”

1. Korporata e Investimeve Shqiptare, këtu “Korporata”, është një shoqëri tregtare aksionere, me kapital 100% shtetëror, e cila ka si aksioner të vetëm Ministrinë përgjegjëse për ekonominë të Republikës së Shqipërisë.
2. Korporata zhvillon projektin e investimit “Zhvillimi dhe menaxhimi i godinave shtetërore”, pjesë e të cilit është nënprojekti “Ndërtimi dhe menaxhimi i Kompleksit Governativ”, nëpërmjet instrumentit ligjor të sipërmarrjes lidhur me dy prona shtetërore, prona për zhvillim me sipërmarrje dhe prona për zhvillim publik, të përcaktuara në Seksionin IV, nënseksioni 2, Informacioni për Pronën, të Dokumentit të Kualifikimit.
3. Projekti i investimit synon të transformojë hapësirat dhe godinat e vjetra shtetërore që shfaqin aktualisht shenja amortizimi, degradimi dhe infrastrukturë të vjetëruar, jo bashkëkohore dhe ku kushtet ekzistuese tregojnë nevojën për të përmirësuar cilësinë e pronave. Interesi publik që përndjek projekti i investimit konsiston në përmirësimin e kushteve të punës së funksionarëve publikë, si dhe në energjizimin e qytetit duke sjellë zhvillimin e zonave urbane ku ndodhen pronat. Projekti realizohet nëpërmjet një modeli partneriteti, ku Korporata ka rolin e zhvilluesit dhe ndërmjetësuesit midis institucionit publik që ka interes të zhvillojë pronat e tij dhe të përfitojë godina bashkëkohore dhe partnerit privat, që posedon burimet financiare, njerëzore dhe

kapacitetet ekzekutive dhe ka interes në realizimin e projektit të investimit.

4. Partneri privat siguron përfitueshmëri të investimit të kryer duke shmangur çdo burokraci dhe paqartësi në lidhje me statusin e pronës (pronë shtetërore e çertifikuar), në marrjen e lejeve (Korporata ka aplikuar për marrjen e lejes së zhvillimit nga KKT mbi projekt-idetë arkitekturore të dy objekteve), si dhe në çdo marrëdhënie me autoritetet publike, por ai gjithashtu në bashkëpunim me Korporatën ndihmojnë në realizimin e qëllimit publik të këtij projekti investimi.
5. Korporata nëpërmjet kesaj procedure konkurruese publike ndërkombëtare synon të përzgjedhë partnerin privat, në cilësinë e Sipërmarrësit për zhvillimin e pronës për sipërmarrje, duke realizuar projekt-idenë arkitekturore të bashkimit të subjekteve Andrea Kaputo & Focus Architecture & OpenFabric & James Beckett.
6. Subjektet që do të hartojnë projektet e detajuara arkitektonike janë përzgjedhur me një konkurs projektimi dhe njihen si “Nënkontraktorë të Emëruar” nga Korporata në përputhje me përcaktimet për “Nënkontraktorët e Emëruar” në Udhëzimet për Aplikantët në Dokumentin e Kualifikimit. “Nënkontraktorët e Emëruar” për nënprojektin “Ndërtimi dhe menaxhimi i godinës së Kadastrës Shqiptare” jepen në Seksionin IV, nënseksioni 4, Nënkontraktorët e Emëruar, të Dokumentit të Kualifikimit.
7. Procedura e konkurrimit për përzgjedhjen e Partnerit Privat do të kryhet nëpërmjet procedurës përzgjedhëse konkurruese me zarf, me dy faza, përkatësisht faza e kualifikimit dhe faza e përzgjedhjes, siç specifikohet në “Rregullore e Procedurave Konkurruese”, të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Korporatës link. Procedura është e hapur për të gjithë subjektet persona fizikë ose juridikë, privatë apo publikë, vendas apo të huaj.
8. Ky Njoftim i Procedurës Konkurruese hap fazën e parë të konkurrimit për përzgjedhjen e Partnerit Privat. Kualifikohen në këtë procedurë konkurrimi aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kualifikimit dhe marrin përsipër angazhimet e përcaktuara në “Dokumentin e Kualifikimit”. “Dokumenti i Kualifikimit” hartohet në gjuhën shqip dhe anglisht dhe publikohet në faqen e internetit të Korporatës link.
9. Në fazën e parë, kandidatët, përveç plotësimit të kriterëve të kualifikimit, duhet të marrin përsipër përmbushjen e angazhimeve/kushteve si më poshtë:
 - j. angazhimin për pagesën e shpenzimeve të konkursit ndërkombëtar të përzgjedhjes së projektit më të mirë të zhvillimit të pronës (vlëra jepet nga Korporata sipas kërkesës);
 - k. angazhimin për pagesën e vlerës së hartimit të projektit të detajuar arkitektonik bazuar në projekt-idenë arkitekturore fituese të konkursit, e cila nuk mund të jetë më shumë se vlëra e deklaruar nga projektuesi (vlëra jepet nga Korporata sipas kërkesës);
 - l. angazhimin për sistemimin në ambiente pune të përshtatshme, të punonjësve të institucioneve publike që aktualisht punojnë në pronat objekt i këtij projekti investimi, për të gjithë periudhën e ndërtimit, deri në dorëzimin e pronës për zhvillim publik (nevojat e institucioneve jepen nga Korporata sipas kërkesës; përshtatshmëria e ambjentëve do të negociohet me Korporatën);
 - m. angazhimin për pagesën e vlerës së taksave, tarifave dhe kontributeve, në kuadër të aplikimit për leje zhvillimi, leje ndërtimi, mbikëqyrjen e punimeve apo çdo fazë të zhvillimit të pronës deri në regjistrimin e pronës së zhvilluar;

- n. angazhimin për regjistrimin e pronës së re dhe kalimin e pjesëve takuese të Korporatës me shpenzimet e partnerit privat;
- o. angazhimi se në pronën për sipërmarrje dhe në pronën për zhvillim publik do zhvillohen projekt-idetë arkitekturore sipas lejes së zhvillimit;
- p. angazhimin e lidhjes së kontratës me “Nënkontraktorët e Emëruar” nga Korporata, për detajimin e projekt-idesë arkitekturore, sipas projekt-idesë arkitekturore të miratuar me lejen e zhvillimit;
- q. angazhimin që me kërkesë të Korporatës nga pjesa takuese e Korporatës në ndërtesën VOID Tower, të zhvillohet plotësisht projekt-idea arkitekturore e Kompleksit Governativ në pronën për zhvillim publik, sipas lejes së zhvillimit;
- r. angazhimi për të lidhur me Korporatën kontratën e sipërmarrjes dhe marrëveshjeve shoqëruese të saj, në përfundim të procesit të përzgjedhjes.

Këto angazhime përbëjnë kushtet paraprake të kontratës së sipërmarrjes, mospërbushja e të cilave sjell pavlefshmërinë e kontratës.

1. Faza e dytë e konkurrimit do ti njoftohet vetëm kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë nëpërmjet dërgimit të Ftesës për Ofertë. Ofertat e paraqitura nga kandidatët në këtë fazë duhet të plotësojnë kriterin bazë, i cili është 45% (dyzet e pesë përqind) dhe do të vlerësohen me kriterin përzgjedhës, i cili është:
 - b. Përqindja më e lartë e sipërfaqjes përkatëse e ofruar për Korporatën në ndërtesën VOID Tower mbi kriterin bazë.

Shpallet fituese oferta që ofron vlerën më të lartë të kësaj përqindje.

2. Të interesuarit mund të marrin informacion të mëtejshëm nga Korporata, në adresën më poshtë, gjatë ditëve të punës, në intervalin 09:00 - 17:00, ora lokale.
3. Aplikimet mund të përgatiten dhe dorëzohen në gjuhën shqip ose anglisht. Dokumentat shoqëruese të aplikimit, nëse janë në gjuhë të ndryshme nga gjuhët shqip dhe anglisht duhet të përkthehen në njëren nga këto gjuhë.
4. Aplikimet duhet të dorëzohen dorazi ose me postë, në adresën e mëposhtme, deri në datë 6 Janar 2025, ora 13:00, ora lokale.
5. Hapja e aplikimeve do të bëhet menjëherë në afatin e fundit për dorëzimin e tyre në adresën e mëposhtme.

Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa: Rr. Ibrahim Rugova 5, Sky Tower 7/1, Tirana, Albania

Email: competition@aicorporation.al;

Adresa e faqes së internetit: <https://aicorporation.al/>